

**Emri i biznesit:** N.SH. Dasma TV

**Numri i biznesit:** 70669188

**Pronar:** NEHAT FEJZA

**OSHMA:** DASMA TV

**Adresa:** Prishtinë



## VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes Dasma TV, me seli në Prishtinë

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. DASMA TV është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA - TV), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 19 nëntor 2010, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA DASMA TV.
3. Me datën 19 nëntor 2020, skadon afati i licencës për DASMA TV, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 9 tetor 2020, OSHMA DASMA TV ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

### Arsyetimi


5. OSHMA Dasma TV, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së duke shfrytëzuar të drejtën e ripërtëritjes së licencës e paraparë me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në.
6. Neni 25 i Ligjit për KPM-në thekson:

*“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”*,

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

### Vendim

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 13 nëntor 2020, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së OSHMA Dasma TV, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
8. Licenca e KPM-së për OSHMA DASMA TV do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 19 nëntor 2020.
9. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA Dasma TV, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.11.2020  
datë